



Në bazë të Nenit 50 paragrafi 1 pika 14 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02) dhe ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 202/24) dhe në lidhje me Nenin 20-g të Ligjit për të Punësuarit në Sektorin Publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 27/14, 199/14, 27/16, 35/18 dhe 198/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 143/19, 14/20 dhe 208/24), Qyteti i Shkupit shpall

### **SHPLLJE PUBLIKE nr. 06/2024 për punësimin e punëtorit në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar**

Përcaktohet nevoja për punësimin e punëtorit në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar për vendin e punës të mëposhtëm:

1. Emërtimi i vendit të punës **Shofer**, shifra UPR0403A03001, Seksioni për punë ndihmëse, Sektori për punë të përgjithshme, **Numri i përmbauesve (1)**.

Kandidatët është e nevojshme t'i plotësojnë kushtet e mëposhtme:

#### **Kushte të përgjithshme:**

- të jetë nënshtrës i Republikës së Maqedonisë,
- të përdorë në mënyrë aktive gjuhën maqedonase,
- të jetë në moshë madhore,
- të posedojë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim gjyqësor të formës së prerë të mos i jetë shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës:

#### **Kushte të veçanta:**

- arsim i mesëm gjimnaz ose arsim i mesëm profesional
- me ose pa përvojë pune

#### **Kushte të tjera të veçanta:**

- patentë shoferi kategoria "B"

Vlera në të holla e pagës bazë neto për vendin e punës Shofer - 33.588 denarë.

Orari i kohës së punës - 8 orë në ditë, 40 orë në javë, nga e hëna deri të premten nga ora 8:30 deri në orën 16:30 часот.

Kandidatët mund ta shkarkojnë **APLIKIMI PËR PUNËSIM të personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit nr. 06/2024** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit [www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk) ose ta marrin në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr.16 në adresën Bul. "Ilinden" nr.82, Shkup.

**Kandidatët janë të obliguar përveç aplikimit për punësim sipas shpalljes publike nr. 06/2024, t'i depozitojnë edhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura (në origjinal ose kopje të noterizuara) si më poshtë:**

- dëshmi për shtetësi;

- dëshmi se me vendim gjyqësor të formës së prerë nuk i është shqiptuar dënim ndalim për kryerjen e profesionit, veprimtarisë apo detyrës;
- dëshmi për përfundimin e nivelit adekuat të arsimit;
- dëshmi për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- dëshmi për posedimin e patentës së shoferit kategoria “B”

Kandidatët nëse kanë përvojë pune është e nevojshme të depozitojnë edhe dëshmi për përvojë pune të evidentuar në Agjencinë e Punësimit.

Kandidatët e interesuar dokumentet e kërkuara duhet t'i depozitojnë në Arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr.16) ose në adresën bul. “Ilinden” nr. 82, Shkup me shënimin - për **SHPLLJE PUBLIKE nr. 06/2024 për punësimin e punëtorit në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar.**

Afati i aplikimit është 7 ditë pune nga dita e shpalljes së shpalljes publike. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e specifikuara në shpallje në momentin e depozitimit të aplikimit.

**Vërejtje:** Nëse kandidati në aplikim nuk ka dhënë të dhëna për kontakt (numër telefoni ose adresë e-mail) aplikimi do të refuzohet.

#### **Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:**

Faza 1: verifikimi i aplikimeve dhe dëshmimeve – realizohet në afat prej 3 ditësh nga dita e përfundimit të shpalljes publike. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni përzgjedhës do të kontaktojë kandidatin nëpërmjet adresës e-mail ose numrit të telefonit në aplikim, dhe ai në afat prej tri ditësh duhet t'i kompletojë dëshmitë, në të kundërt aplikimi do të refuzohet. Aplikimi do të refuzohet edhe nëse dëshmia/dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: intervista e kandidatëve të përzgjedhur – realizohet në afat prej 10 ditësh pas realizimit të fazës së dytë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës për përzgjedhje janë rregulluar në mënyrë të hollësishme në **RREGULLORE për punësimin e personave ndihmës – teknikë në Qytetin e Shkupit**, e cila është shpallur në ueb-faqen e Qytetit të Shkupit ([www.skopje.gov.mk](http://www.skopje.gov.mk)).

**QYTETI I SHKUPIT  
KRYETARJA E QYTETIT TË SHKUPIT**